**KËRKESË**
**Nr. 492/9, datë 5.7.2024**

**PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit 'Sistemim i rrugës 'Andrea Stathi', Bashkia Korçë".

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Korçë.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur për pasuritë e llojit "truall", bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë", sipas tabelës bashkëlidhur.

Personat që preken nga ky projekt të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken, por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, në Bashkinë Korçë, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimet.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është *1 545 197 (një milion e pesëqind e dyzetë e pesë mijë e njëqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekë*.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
**Kastriot Gurra**

TABELA PARAPRAKE ME LISTËN EMËRORE “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT
“PËRMIRËSIMI I SHTRESAVE RRUGORE, RRUGA ‘ANDREA STATHI’, BASHKIA KORÇË”

| Numër rendor | PRONARI | | | | TË DHËNA HIPOTEKORE | | | | | | | | | | VLERA TOTALE (LEKË) | Shënime |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | | | | “TRUALL” | | | | |
| | Emër | Atësi | Mbiemër | Fshati ose qyteti | Z. kadastrale | Nr. i pasurisë | Lloji i pasurisë | Sipërfaqja totale | Truall (m²) | Volum | Faqe | Sipërfaqja (m²) | Çmimi lekë/ m² | VLERA (m²) | | |
| | A | B | C | C | Ç | D | E | F | H | J | K | P | Q | R | Z | Zh |
| 1 | Migena | Jorgji | Demirxhiu | Korçë | 8564 | 7/292 | Truall | 915.00 | 915.00 | 17 | 226 | 181 | 8,537 | 1.545.197 | 1,545,197 | Ka shënime te seksioni C- TË DREJTAT REALE. Mbi këtë pasuri ndodhet pasuria me nr. 7/1277-Nd vol.42 f.27 në pronësi të Z. Artan dhe Liu Zyfiu. Dhe një pjesë e saj është pjesë e parcelës ndërtimore të lejes së legalizimit. Nuk ka shënime seksioni D- KUFIZIMET E PRONËSISË. Ka shënime seksioni E - INFORMACIONE TË TJERA PËR PRONËN. Pjesëtim vullnetar pjesa "B" 012602 më dt. 29.3.2021 e bërë rivlerësimi 9,150,000 lekë bashkëpronarët janë Alfred Hamzai 1/4 pjesë, Fatiko Hamzai 1/4 pjesë Migena Demirxhiu 1/4 pjesë, Jolanda Hamzai 1/4 pjesë. 018048. Regj. prokurë për tërheqje Ç.P. nga Viollanda Sutikno; Fatiko Hamzai; Alfred Hamzai për Migena Demirxhiu 018198 korrigjim harte me urdhër të brendshëm. |
| | Viollanda | Enver | Sutikno | | | | | | | | | | | | | |
| | Fatiko | Enver | Hamzai | | | | | | | | | | | | | |
| | Alfred | Enver | Hamzai | | | | | | | | | | | | | |
| *TOTALI* | | | | | | | | | | | | | | | **1,545,197** | |